



## Sektori i Transportit

### Transporti dhe Licensat Profesionale

- Pergatit gjithë dokumntacionin ligjor mbi politikat e Bashkise mbi Taksite, Sherbimet e Autobuseve, Sherbimin e Transportit te Mallrave, si dhe Sherbimin e Tregimit te Gazit te Lengshem;
- Mbledh qe te gjithë aplikimet si dhe dokumentat shoqerues mbi sherbimet e mesiperme dhe ja prezanton ato Komisionit te Licensimit prane Bashkise;
- Kontrollon mbi sherbimet e ofruara prej marresve te licensave dhe autorizimeve per gjate gjithë periudhes se vlefshmerise se tyre;

Procedurat e aplikimit per secilen prej licensave dhe autorizimeve jane si me poshte vijon :

### Sherbimi Taksi

Per tu pajisur me nje license per Sherbimin Taksi duhen kryer hapat e meposhtem :

Dokumentat e meposhtme duhen dorezuar prane drejtorise se mesiperme :

- Kerkese me shkrim e aplikantit;
- Nje fotokopje e noterizuar e NIPT-it, e leshuar prej QKR-se;
- Nje vertetim prej Drejtorise se Tatim – Taksave prane Bashkise Lushnje, qe trgon se detyrimet e taksave per vitin e kaluar jane e paguar;

- Nje vertetim nga Drejtoria e Taksave ne Bashkine Lushnje per shlyerjen e detyrimeve te vitit ne vazhdim;
- Certifikaten e Vleresimit Teknik te Automjetit (originalin ose nje fotokopje te noterizuar);
- Nje fotokopje te noterizuar te Regjistrimit te Automjetit;
- Nje fotokopje te noterizuar te Certifikates se Inspektimit te Automjetit;
- Nje fotokopje te noterizuar te Deshmise se Taksistit e vlefshme per te pakten dhe nje vit nga data e aplikimit;
- Nje fotokopje te noterizuar te Lejes se Drejtimit, vetem ato te aplikuesve te pajisur me klasin D do te pranohen;
- Nje vertetim nga Kryetari i Rajonit, qe jeni banor I rajonit dhe prej sa vitesh jetoni ne ate rajon;
- Nje vertetim qe eshte kryer pagesa e Sigurimeve Shoqerore per vitin paraardhes;
- Nje vertetim nga Zyra e Kadastres prane Bashkise, qe deklarone nese aplikanti apo pjesetaret e familjes se tij kane toke bujqesore;
- Nje vertetim nga Drejtoria e Sherbimeve Sociale prane Bashkise Lushnje, qe deklarone nese aplikanti merr ndihme sociale;

### -Kerkesat e mjetit.

- Te jete jo me i vjeter se 15 vjet;
- Ngjyra e makines duhet te jete e bardhe;
- Certifikata per kalibrimin dhe vulosjen e taksimetrit, e leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme Metrologjike;
- Te kete vendosur 2(dy) Ngjitesa me Numrin e Taksise, tek ted y dyert e para, edhe tek dera e shoferit edhe tek dera e pasagjerit (jepen prej Drejtorise se Transportit dhe Licensave Profesionale);
- Te kete vendosur nje vije me katrorre te kuq, me dimensione 50\*50mm, tek ted y dyert e para, edhe tek dera e shoferit edhe tek dera e pasagjerit;

- Te kete vendosur mbi catine e makines nje tablete te ndricueshme me dimensione 15\*35cm, me fjalen TAKSI te shkruar qarte mbi te;
- Aplikanti duhet te kete reputacion te mire dhe ti kete paguar te gjitha taksat ndaj qeverisjes locale dhe qendrore.

### -Sherbimet e Autobuseve

Ky lloj sherbimi ndahet ne tre kategori, te cilat vijojne me poshte si dhe dokumentat per secilen prej tyre :

#### 1. Sherbimi Urban ne Qytet

- Nje kerkese me shkrim nga aplikanti;
- Nje fotokopje te noterizuar te NIPT-it, e leshuar nga QKR-ja;
- Nje deklarate nga aplikanti, qe deklarone se ai e ka siguruar oficinen mekanike dhe parkimin e sigurte per autobuset;
- Nje vertetim nga nje kompani Sigurimesh, qe deklarone se aplikanti ka "siguracione kasko" per te gjithë autobuset, apo nje certificate nga nje banke qe deklarone se aplikanti ka depozituar fondet e nevojshme per te pasur nje garanci bankare mbi autobuset;
- Certifikaten e Vleresimit Teknik (original), per cdo autobus qe do te perdoret nga aplikanti;
- Certifikaten e Regjistrimit dhe Lejen e Qarkullimit per cdo autobus qe do te perdoret nga aplikanti;
- Kontratat e punes ndermjet aplikantit dhe shofereve, qe do te punesohen per te ofruar sherbimet;
- Nje studim ekonomik dhe financiar, sipas karakteristikave te linjes apo linjave, qe aplikanti do te mbuloje me sherbimet e tij. Te jete pajisur me C.K.P;
- Adresen e zyres se aplikantit;
- Informacion mbi shkollimin e personelit;

## 2. Shërbimi me autobus Brenda qarkut :

- Nje kerkese me shkrim nga aplikanti;
- Një fotokopje të noterizuar të NIPT-it, e lëshuar nga QKR-ja;
- Çertifikatën e Vlerësimit Teknik (origjinal), për çdo autobus që do të përdoret nga aplikanti;
- Çertifikatën e kontrollit teknik dhe Lejen e Qarkullimit për çdo autobus që do të përdoret nga aplikanti;
- Kontratën ndërmjet aplikantit dhe një agjencie udhëtimi, e ndodhur në stacionin e autobusëve në stacionin e fundit të linjës, me vendim të Këshillit të Qakut, dhe që ka një liçensë të vlefshme agjencie udhëtimi;te licensuara nga Bashkia.
- Adresën e zyrës së aplikantit;
- Kontratën e punës ndërmjet aplikantit dhe shoferëve, që do të e parashikuar si dhe informacione mbi shkollimin e personelit Një deklaratë nga aplikanti, që deklaron se ai e ka siguruar ofiçinën mekanike dhe parkimin e sigurtë për autobusët;

## 3. Shërbimi per linjen ndërqrqyte tëse:

- Një kërkesë me shkrim nga aplikanti;
- Raporti Statistikor Vjetor i aktivitetit të aplikantit, i shoqëruar me evidencat statistikore të plotësuar, sipas formatit të aprovuar;
- Një fotokopje të noterizuar të NIPT-it, e lëshuar nga QKR-ja;
- Akt-themelimi, statuti për aktivitetin e transportit ndërqrqytes;
- Adresën e zyrës së aplikantit, e vërtetuar nga Drejtoria e Transportit të Bashkisë;
- Kontratën ndërmjet aplikantit dhe një personi tjetër juridik që punon në anën tjetër të linjës. Nëse linja do të punohet vetëm prej autobusëve të aplikantit atëherë kontrata me një agjenci udhëtimi e licensuar nga Bashkia. Një grafik të

detajuar të linjës për një muaj, dhe një grafik të planifikuar për një vit;

- Dokumentacionin e nevojshëm për çdo autobus që do të përdoret në këtë linjë;
- Një kopje të Çertifikatës së Kontrollit Teknik dhe Lejes së Qarkullimit (nëse autobusi nuk është në pronësi të aplikantit, një kontratë qeraje e noterizuar duhet të paraqitet);
- Aktin e Vlerësimit Teknik, original ose (Fotokopje e Noterizuar)
- Dokumentacionin e mëposhtëm për çdo shofer autobusi që do të punojë në këtë linjë:
- Fotokopje të Lejes së Drejtimit (klasi D);
- Kontratë Pune,(lista e te punesuarve nga zyra rajonale e punesimit)
- Dokument për arsimin e administratorit .
- Një deklaratë nga aplikanti, që deklaron se ai e ka siguruar ofiçinën mekanike dhe parkimin e sigurtë për autobusët;
- Një vërtetim nga banka që deklaron se aplikanti ka një llogari bankare në Lekë;
- Një vërtetim nga një kompani Sigurimesh, që deklaron se aplikanti ka siguracion kasko për të gjithë autobusët, apo një çertifikatë nga një bankë që deklaron se aplikanti ka depozituar fondet e nevojshme për të pasur një garanci bankare mbi autobusët;
- Një kontratë ndërmjet aplikantit dhe Drejtorisë Rajonale të Hekurudhave, në rast se linja fillon apo përfundon në një destinacion me stacion treni, kështu që most ë ketë ndonjë konflikt për sa u përket orareve të nisjes apo mbërritjes.

## Shërbimi i Transportit të Mallrave (Transport Mallrash Per Vete e Per te Trete)

-Për të marrë një liçensë për këtë shërbim, nevojiten:

- Kërkesë me shkrim e aplikantit;
- Një kopje e Lejes së Qarkullimit
- Një kopje e Çertifikatës së Taksave. Kontrollit teknik.
- Nje kopje e Certifikates se Tatimore ose NIPT

- Vërtetim nga Drejtoria e Tatim Taksave per shlyerjen e detyrimeve vendore
- Vërtetim nga drejtoria rajonale Fier per shlyerjen e detyrimeve tatimore te vitit paraardhes(Sigurime Shoqerore)

## Autorizime Mujore per Qarkullim ne Territorin e Bashkise.

- Autorizime mujore per qarkullim ne territorin e Bashkise te mjeteve te tonazheve te renda (kryesisht betoniere per ndertim ) si dhe mjeteve te tjera te cilat nuk jane object licencimi.

## Shërbimi i Tregtimit të Gazi të Lëngshëm Dhe Karburanteve me Pakice

Për të marrë autorizim dhe për të ofruar këtë shërbim, duhen:

- Vendimin e gjykates per regjistrimin si person juridik
- Certifikaten e regjistrimit ne zyren tatimore
- Projektin teknologjik te depove dhe linjave te miratuar nga organet e qeverisjes vendore te mbrojtjes nga zjarri e te mjedisit
- Aktin e kontrollit dhe lejen e shfrytezimit te leshuar nga zyra e urbanistikes .
- Vërtetimin per kontrollin e objektit per respektimin e kushteve teknike te leshuar nga Inspektoriati Shteteror I Kontrollit ,Naftes ,Gazit dhe Nenprodukteve te tyre.
- Certifikaten e Kalibrimit te rezervuarve te vendosur ne stacion dhe te matjes se aparateve te shitjes se karburanteve,te leshuar nga organet e metrologjise e te kalibrimit ne njesite Qeverisjes Vendore.
- Pagesa per autorizimin eshte 100 000 lek per 5-vjet me te drejte rinovimi
- Autorizim per hyrje,dalje ne piken e karburantit apo gazit te lenget.